

REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KRUIJË  
KESHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 04 Date 21/11 /2016

**“Mbi miratimin e projekt-preventivit (projekt idese dhe preventivit paraprak ) per menaxhimin e situates pas permbytjeve te dates 08.11.2016”**

Bashkia Krujë ,mbeshtetur ne ligjin Nr.139/2015 “Për veteqeverisjen vendore” Ligji Nr. **8756**, datë **26.3.2001** “Për Emergjencat Civile” ,Ligjin 147/2015 “Per buxhetin e vitit 2016”, VKM nr 329 date 16.05.2012 “Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shtetore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesite natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore,me qellim marrjen e masave emergjente per parandalimin e permbytjeve te mundshme dhe mbrojtjen e jetes se qytetareve” si dhe relacionit perkates te propozuar nga strukturat perkatese te emergjencave civile si dhe propozimit te kryetarit te Bashkisë :

**VENDOSI :**

1.Të miratoje,**Projekt-preventivat (projekt ideja dhe preventivat paraprake me objekt si vijon:**

a)“Mbrojtje emergjence ne brigjet e Lumit Zezë ”Bashkia Krujë, me vleren e preventivit prej 18’455’712 (tetembedhjete million e katerqinde e pesedhete e pese mije e shtateqinde e dymbedhjete ) leke me t.v.sh .

b)-Ndertim Ure Hd=10 dhe mur mbajtes në perroin e Bardharit ,Fshati Halil, Fushë -Krujë me vlere preventivit te miratuar ne shumen prej 14’984’372(katermbedhjetemilion e nenteqinde e tetedhete e kater mije e treqinde e shtatedhete e dy) leke me t.v.sh.

c)Mbrojtje Lumore dhe Riparim I Ushqyesit te Dollakes, me vlere preventivit ne shumen prej 6’909’266(gjashtemilion e nenteqinde e nentemije e dyqinde e gjashtedhete e gjashte) leke me t.v.sh.

d)Rikonstruksion ,zgjerim dhe mbrojtje lumore e ures se Vrionit me vlere preventivit ne shumen prej 8'156'998(tetemilion e njeqinde e pesedhjte e gjashte mije e nenteqinde e netedhjte e tete).

2.Ngarkohet per zbatimin e ketij vendimi Drejtoria e Sherbimeve dhe Investimeve Publike.

**Ky vendim hyn ne fuqi pas konfirmimit per bazueshmeri ligjore nga Prefekti Qarkut Durres.**

**KRYETARI I KESHILLIT**

**HYSNI CACA**

